

UDHËZIM
Nr. 160, datë 25.1.2007

**PËR “PROCEDURAT E NDALIMIT, SEKUESTRIMIT DHE KONFISKIMIT TË
MJETEVE PËR KUNDËRVAJTJE ADMINISTRATIVE”**

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 238, datë 8.2.2008; nr. 243, datë 22.4.2009)

(i përditësuar)

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 201, 206, 209, 210 e 211 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 7 të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.286, datë 30.5.1994 “Për administrimin e sendeve që kalojnë në dobi të shtetit nga kundërvajtjet administrative”, nenit 360, 361 dhe 364 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000, rregullores “Për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, me qëllim unifikimin e procedurave për sekuestrimin dhe konfiskimin e mjeteve,

UDHËZOJ:

1. Në rastet kur Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë parashikon masën plotësuese të ndalimit, sekuestrimit dhe konfiskimit administrativ të mjetit, punonjësi i Policisë Rrugore, që konstaton shkeljen, merr masa për bllokimin, transferimin ose tërheqjen e mjetit në vendin e zgjedhur për ruajtje.

Transferimi ose tërheqja e mjetit bëhet me anë të mjeteve që mendohen më të përshtatshme për të mos e dëmtuar atë. Në këto raste punonjësi i Policisë Rrugore bën shënimet përkatëse në procesverbalin e ngarkimit të shkeljes.

2. Ruajtja e mjeteve të ndaluara, sekuestruara dhe konfiskuara bëhet në vendet e caktuara sipas rregullave të parashikuara në rregulloren “Për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”.

3. Organi administrativ, brenda 10 ditëve, shqyrton masën e ndalimit, sekuestrimit dhe konfiskimit administrativ dhe shpall vendimin. Vendimi hartohet në tri kopje. Një kopje e vendimit i dërgohet zyrtarisht personit të interesuar dhe që ka lidhje organike me mjetin.

Kur nga verifikimi i çështjes del që mjeti është pronë e personave që nuk kanë lidhje me shkeljen administrative, masa e konfiskimit nuk zbatohet.

4. Pasi vendimi i organit administrativ, që ka marrë formë të prerë, nuk është ankimuar pas njoftimit zyrtar të personit të interesuar brenda 5 ditëve në gjykatë, merren masa për transportimin dhe dërgimin e mjetit në Rezervat e Shtetit nga organet e Policisë së Shtetit, *jo më vonë se 25 ditë nga data që vendimi i organit administrativ ka marrë formë të prerë.*

Mjeti shoqërohet me këto dokumente:

a) vendimin e organit administrativ;
b) procesverbalin për çdo mjet, duke përshkruar gjendjen teknike të tij;
c) çdo dokument të bllokuar kundërvajtësve ose të nxjerra në mënyrë elektronike nga arkivat përkatëse;

d) detyrimet financiare që i përkasin mjetit të bllokuar.

5. Mjetet që kalojnë në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit bëhen objekt shitjeje ose transferimi pa pagesë në institucione, me urdhër të Kryeministrit.

5.1 Në administrim për shitje, të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, kalojnë edhe mjetet, ndalimi i të cilave është bërë sipas nenit 203 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

6. Mjetet e ndaluara, sekuestruara dhe të konfiskuara, që gjenden aktualisht në pikat e

bllokimit pranë komisariateve të policisë, të cilat konsiderohen në gjendje pune për qarkullim, trajtohen sipas pikës 4. Për mjetet e tjera, të cilat, për shkak të amortizimit dhe gjendjes së përgjithshme, nuk konsiderohen në gjendje pune, bëhet shkatërrimi dhe shitja e tyre si skrap.

7. Kriteret e vlerësimit dhe të kategorizimit të mjeteve janë:

- a) viti i prodhimit;
- b) kilometrat e përshkruar;
- c) gjendja teknike e motorit;
- d) normat e harxhimit të karburantit për 100 km;
- e) gjendja teknike e pjesëve xhenerike;
- f) pamja e jashtme e mjetit dhe tapiceria.

8. Për kategorizimin e mjeteve merret vendim nga “Komisioni i Vlerësimit të Mjeteve”, i cili ngrihet me urdhër të Drejtorit të Policisë së Qarkut, ku gjenden mjetet e konfiskuara, i përbërë nga:

- a) *Shefi i Sektorit të Rendit të Policisë së Qarkut – kryetar;*
- b) *shefi i logjistikës në drejtori, anëtar;*
- c) *shefi i seksionit të policisë rrugore në komisariatin e policisë, anëtar;*
- d) *specialist i administratës së Rezervave të Shtetit, anëtar;*
- e) *shefi i sektorit të luftës kundër trafikeve në drejtorinë e policisë së qarkut, anëtar;*
- f) *specialisti i automekanikës në drejtori të policisë së qarkut, anëtar.*

Komisioni vendos për:

- 1. mjetet që plotësojnë kushtet teknike për qarkullim.
- 2. Shfuqizuar.
- 3. mjetet që do të shkatërrohen dhe do të bëhen objekt shitjeje për skrap.

4. Përcaktimin e peshës reale të mjeteve me mangësi të dukshme.

Automjetet e sipërpërmendura kalojnë pranë Rezervave të Shtetit sipas rregullave në fuqi.

9. Mjetet e kategorizuara sipas pikës 8/3, u shiten shoqërive të licencuara për shkatërrim mjetesh, për skrap ose për shkrirje metalesh, pasi të hiqen nga qarkullimi, sipas nenit 102 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Çmimi i shitjes përcaktohet për kilogram për skrap, duke përpiluar dokumentacionin e mëposhtëm:

- h) vendimin e organit administrativ;
- i) procesverbalin për çdo mjet, duke përshkruar gjendjen e tij;
- j) pamje fotografike të mjetit;
- k) çdo dokument të bllokuar kundërvajtësve ose të nxjerrë në mënyrë elektronike;
- l) njoftimet zyrtare të bëra kundërvajtësit;
- m) llogaritjen e detyrimeve për gjobën, tarifat e ruajtjes dhe çdo shpenzim tjetër të bërë për mjetin;
- n) procesverbalin për çmimin e shitjes dhe mandatarkëtimin;
- o) njoftimin për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për heqjen e mjetit nga qarkullimi, dërgimin e targave dhe çregjistrimin e mjeteve.

10. Të ardhurat e realizuara nga shkatërrimi i mjeteve do të kenë destinacionin si vijon:

- a) të ardhura për likuidimin e vlerës së gjobës;
- b) të ardhura për likuidimin e kamatëvonesës;
- c) të ardhura nga parkimi dhe shpenzime ndërhyrjeje dhe transporti;
- d) mbetja e mundshme t’i kthehet atij që i takon.

11. Transportimi i mjeteve të kategorizuara sipas pikës 8/1, për në Rezervat Materiale të Shtetit, bëhet me mjetet e Ministrisë së Brendshme.

Transportimi i mjeteve të kategorizuara sipas pikës 8/3, bëhet nga Blerësi Publik.

12. Dokumentet sipas pikës 7 dhe 9 administrohen në fashikuj të veçantë dhe arkivohen

pranë sekretarisë së organit me afat ruajtjeje jo më pak se 10 vjet.

13. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen drejtoritë e policisë së qarqeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave *Materialle* të Shtetit.

14. Për kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Planifikimit Financiar në Ministrinë e Brendshme.

15. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e tij edhe për mjetet e sekuestruara deri në hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.

MINISTRI I BRENDSHËM
Sokol Olldashi